VITI XIV, NUMRI 7/KORRIK

# FOREVER

HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA



## EUROPEAN & WORLD RALLY VIENNA 2011








15-16. 04. 2011. WIENER STADTHALLE



# Qëndrueshmëria

*Këtë letër e shkruajta kur po kthehesha nga një udhëtim i gjatë një mujor. Për gjysëm viti vizitova pothuajse gjithë kontinentin. Kjo ishte periudha e Rally-ve rajonale fantastike. U taakova me turmën e madhe të distrubutorëve, me njerëz të cilët mezi presin të dinë se çfarë u sjell atyre FOREVER. Fola me mijëra prej tyre. Më magjepsën historitë e tyre rreth qëndrueshmërisë dhe suksesit. E di që nuk është e thjeshtë të ndërtosh një biznes, por për gjërat që arrihen shumë lehtë, nuk ia vlen të luftosh.*

*Në momentet kur ke dyshime dhe je i pasigurt, të vij ndër mend historia e piktorit të njohur amerikan, Norman Rockwell. Rockwell gjatë jetës së tij pikturoi kopertinat e disa qindra revistave. Por ai ishte ndryshe nga piktorët e tjerë. Jo vetëm e pikturoi jetën, por edhe e jetoi atë. Ashtu si ne, edhe Rockwell njohi fitoren, triumfin, gëzimin. Por u takua edhe me zinë dhe disfatën.*

*Kur ishte i ri, si piktor fillestar Rockwell mësoi se si duhet ecur mëtej edhe kur situata duket e pashpresë. Megjithëse përgatiti më shumë se 300 piktura kopertine për Saturday Evening Post – me të cilën kishte lidhje të ngushta – kjo shtëpi botuese ishte ajo që i kishte refuzuar një ilustrim të herët. Mendoni se Rockwell hoqi dorë? Sigurisht që jo. Ju kujtua një fjali që kishte lexuar dikur në një libër: „Nëse rrëzohesh, mos qëndro shtrirë dhe rënko, por ngrihu."*

*Në vend që të pranonte disfatën, shkoi në një revistë tjetër dhe e shiti pikturën. Dhe të nesërmen përgatiti kopertinën për Saturday Evening Post. Ky është morali që duhet të përdorim edhe në biznesin tonë FOREVER. Kur dikush të thotë jo, mos u dëshpëro. Por shko thjeshtë tek njerëz të tjerë, derisa dikush të thotë po. Dhe mos i harro njerëzit me të cilët fole. Ndoshta sot nuk janë akoma gati, por në jetë gjithçka ndryshon. Ndoshta nesër do të tregohen të hapur ndaj kësaj mundësie fantastike.*

*Siç e përmenda Rockwell përgatiti më shumë se 300 piktura kopertine për Saturday Evening Post. Çdo pikturë e tij tregonte jetën e përditshme, por prapë transmentonte vlera të mëdha. Rockwell jo vetëm pikturonte; por ishte një tregues që pati efekt në një gjeneratë të tërë. Frymëzohej nga jeta e përditshme. Ishte i aftë të shkaktonte lotë dhe buzëqeshje në fytyra. Na ngushëllonte dhe na qetësonte, na tregonte se të gjithë ne kemi dëshira, ëndrra dhe përvoja të thjeshta të përditshme.*

*Autobiografia e artistit përfundon me fjalët: „Çdo ditë ngrihem herët në mëngjes, nga ora tetë punoj… E kam kuptuar prej kohësh që nuk kam për t'u bërë aq i mirë sa Rambrandti. Por gjatë punës sime jam zhvilluar shumë. Çdo pikturë e filloj me po ato shpresa dhe kërkesa të larta të cilat ndoshta s'kam për t'i plotësuar kurrë, por përpiqem vazhdimisht të jap më të mirën nga vetvetja." Ky mund të jetë një mendim i mirë për jetën tonë. Shpresoj se s'do të arrij kurrë në pikën kur nuk mund të zhvillohem më.*

*Kur unë them që t'i festojmë gjithmonë sukseset tona, asnjëherë nuk mendoj që të ndjejmë se e plotësuam detyrën tonë. Ka akoma shumë njerëz të cilët kanë nevojë për atë që ofron FOREVER. Që të kuptojnë se çdo të thotë shëndeti dhe pasuria e vërtetë. Shpresoj të përpiqeni vazhdimisht sin ë jetë, edhe në biznes. Gjithmonë mund të bëjmë më shumë. Provojeni përsëri, dhe përsëri!*

*Norman Rockwell vdiq në moshën 84 vjeç, në pëlhurë shihej një pikturë e papërfunduar. Ishte i angazhuar pas pikësynimeve të tij, dhe qëndrueshmëria e veçantoi nga turma. Shpresoj që nëpërmjet pikësynimeve dhe qëndrueshmërisë suaj edhe ju të ngriheni mbi të tjerët.*

REX MAUGHAN



# KAMPIONATI BOTËROR

*Është duke u zhvilluar një nga garat më popullore të sportit në Afrikën e Jugut, ndërkohë që edhe skuadra jonë e Forever-it filloi një trainim të fuqishëm në kampin e Poreçit.*

*Atmosferë fantastike, bori, daulle, zile në Poreç, tromba në Johannesburg. Gumëzhin publiku, ndeshjet janë të shkëlqyera, kurse lektorët sensacional. Ndërkohë që më në jug skualifikohen me radhë kombëtaret, në Poreç kombëtaret e tetë shteteve të Forever-it e rrisin gjithmonë e më më shumë shpejtësinë.*

*Duhet të sundojmë botën. Duhet të mendojmë vetëm këtë, nuk duhet të kemi përpara pikësynim tjetër. Për këtë ekziston një mënyrë e vetme: secili i vë vetes pikësynime të cilat deri tani nuk guxonte.*

*BËHU DIAMANT!*

*Guxo ta bësh, guxo ta imagjinosh, guxo të veprosh për të dhe të garantoj që nëse e merr vendimin, atëherë ne jemi me ty, të ndihmojmë, të mbështesim. Kur e arrin, bëhesh shembull për ne, dhe ndërkohë të duam, bëhemi miq dhe kujdesemi për ty.*

*Në Poreç u mblodhën rrjendërtuesit më të mirë të botës. Me një skuadër të vogël, skuadrën e shpresave të Forever-it, prej të cilëve do të bëhen diamantët e të ardhmes. Ata e dinë këtë gjë, me këto pikësynime dhe mendim kthehen në shtëpi, pritini ata si kampionë bote!*

*Në çdo lojë skuadre një nga çështjet më të rëndësishme është ajo e shpresave. Në radhët tona hyjnë vazhdimisht punonjës të rinj, rrjetndërtues profesionist i marrin përdore, i ngjisin në shkallën e parë të sistemit marketing dhe dorë për dore, duke u dhënë njohuritë e tyre më të mira i udhëheqin ata drejt bonuseve më të larta të sistemit marketing.*

*Çfarë duhet të bësh për të hyrë në një skuadër suksesi që të jep shëndet dhe siguri materiale?*

*Dëgjoje mundësinë, mos e shmang atë, sepse ta kesh të qartë që kjo ka për t'u ndërtuar edhe pa ty dhe s'ia vlen të qëndrosh jashtë. Tregohu i vëmendshëm, dëgjoje thelbin, ec me sy hapur dhe shiko të ardhmen tënde! Gjithçka varet nga ty dhe vendoset në mendjen tënde. Guxo të hedhësh një hap, s'ka rëndësi se çfarë thotë komshiu, bëhu anëtar i kësaj skuadre që përparon me hapa madhështore, pastaj duke mësuar shumë bëhu drejtues i vërtetë, anëtar i vlerësuar i skuadrës!*

*Duhet të punosh që të vlerësohesh. Duaje këtë mundësi që të ofrojnë, sepse përveç mirëqenies materiale të jep edhe vlerësim, sukses dhe respekt. Zgjidh një pikë të sigurt në jetën tënde dhe vish bluzën e skuadrës sonë kombëtare!*

*Përpara FLP Hungari!*

DR SANDOR MILESZ
DREJTOR GJENERAL





# Në Szirak

## *është zhurmë e gjullurdi e madhe*

**Dhe në këtë rast nuk martohet vajza e kryeplakut. Por është takimi i menaxherëve të Forever-it që gjalléron zonën. S'është e lehtë ta përshkruash me fjalë atmosferën. Unë në Szirak nuk kam parë ndonjëherë të mblidhen kaq njerëz! Është një surprizë e këndshme që me ne bashkohen gjithmonë e më shumë njerëz edhe jashtë kufijve të rajonit tonë. Vijnë mysafirë nga Austria, Rumania, Sllovakia, Çekia, Polonia, madje edhe nga Suedia. Kjo justifikon ekzistencën e një komuniteti të përjetshëm që shtohet dhe zhvillohet vazhdimisht nën idetë e Forever-it.**








Takimi i Menaxherëve në radhë të parë është natyrisht një aktivitet profesional. Këtu mblidhen rrjetndërtuesit drejtues të Europës që t'u japin shembull të tjerëve, dhe nëpërmjet kësaj të përcaktojnë një rrugë të suksesshme. Me këtë rast duke marrë në konsideratë praninë e krijuesit dhe presidentit të shoqërisë sonë **Rex Maughan**, dhe drejtuesit të Europës **Aidan O'Hare** mund të deklarojmë pa frikë që në Szirak takohemi jo vetëm me rrjetndërtuesit drejtues më të rëndësishëm të Europës, por edhe të gjithë botës.
Forever i pret mysafirët me shërbime të organizuara në nivel të lartë siç e ka zakon: ata që dëshirojnë të blejnë priten nga një komplet i plotë produkesh, dhe një administratë e plotë shërben të interesuarit për flotën telefonike Forever. Personeli i hotelit të kështjellës lëviz vazhdimisht mes mysafirëve me pjatat e mbushura plot.
Festa filloi me hapjen e një ekspozite. Në galerinë e hotelit të kështjellës u shfaq ekspozita me titull *„Pal Teleki në periudhën e Horthy-t"*. Rëndësinë e jashtëzakonshme historike dhe shoqërore të ekspozitës e shprehu doktori i shkencës së historisë, drejtori i universitetit ELTE, Dr. Tibor Seifer phd. Me prerjen e shiritit **Rex Maughan** dhe **Dr. Sandor Milesz** bënë hapjen e ekspozitës për publikun. Rex Maughan e quajti Szirakun një simbol me vlera shembullore, i cili tregon qartë se sa shumë gjëra mund të realizojmë duke u mbështetur tek traditat dhe duke punuar shumë.







Programi profesional hapet nga përshëndetja e drejtorit gjeneral **Dr. Sandor Milesz**. Edhe mes atmosferës festive nuk harron të na kujtoj për ndihmën e zonave të dëmtuara nga katastrofat natyrore që ndodhën jo shumë kohë më parë. Pastaj flet rreth një perspektive të re, rreth mundësive të ndryshimit të gjeneratave. Tregon përpjekjet e Forever-it në zhvillimin e komunikimit dhe përcjelljes së informacioneve.

**Jozsef Szabo**, i cili ishte i pari që veshi bluzën e Forever-it në Europën Lindore, nxjerr në skenë në mënyrë simbolike shenjën NDRYSHIM. Merr një duartrokitje të madhe për këtë.
Nën drejtimin e diamant-safir menaxherëve **Attila dhe Katalin Gidofalvi** pjesëtarët e World Rallyt të fundit, diamant-safir menaxheri **Miklos Berkics**, diamant menaxherët **Veronika dhe Stevan Lomjanski**, safir menaxheri **Adolf L. Kosa** dhe Drejtori Operativ i Europës **Peter Lenkey** ndajnë me dëgjuesit mbresat e tyre motivuese. Ata kanë të njëjtin mendim: në World Rally mund të shkoj ai që dëshiron me të vërtetë!

Drejtori i Europës **Aidan O'Hare** nuk lë pa falenderuar në mënyrë të veçantë kombet pjesëmarrëse. Duke u bazuar tek traditat dhe historia e Forever-it jep pamjen e vizioneve të mëdha. Radhit gjatë shembuj: tregon gjëra të cilat disa vite më parë dukeshin të paimagjinueshme. *„Ky është çelësi i suksesit – përmbledh – besojmë në gjëra që as nuk ekzistojnë."* Pastaj në mënyrë të denjë për një kolonel të Flotës Ushtarake Amerikane, udhëheq një lojë të thjeshtë por tepër shprehëse, që modelon metodat bazë të ndërtimit të rrjetit. Një eksperiencë që të krijon pikëmapje të vërtetë!

















**Aranka Vagasi** si diamant-safir menaxhere merr përsipër që në disa minuta të tregoj sekretet e përvetësimit të Profit Sharing. Këtë e bën përvoja shumëvjeçare. Duke e kaluar kufirin e leksionit edhe tani, këtu në skenë vepron: e menaxhon skuadrën e saj si një dejtuese e vërtetë.
Në skenë përshëndetet me duatrokitje të mëdha një nga rrjetndërtuesit më të njohur të Europës dhe gjithë botës, pronari i çekut më të madh të ndarjes së profitit, diamant-safir menaxheri **Miklos Berkics**. Ai i tregon publikut sekretet e mënyrës së tij të menaxhimit me dinamizimin e tij të zakonshëm. Duke dëgjuar **Veronika Lomjanski**-n kur tregon rreth mbresave të rrugës që e çoi deri tek niveli i diamant menaxherit, të gjithë mbushen me besim. Fjalët e saj na nxisin për t'i bërë analizë vetvetes, që të përballemi me gabimet tona, që duke i hedhur poshtë pretekstet, të nisemi me forca të reja drejt pikësynimeve tona.
Një emocion i kuptueshëm dhe pritje e madhe parapriu fjalimin e njeriut i cili e ëndërroi, e krijoi Forever-in dhe deri më sot e menaxhon në nivel të lartë botëror. Rex Maughan i përshëndet të mbledhurit mes duartrokitjeve të mëdha. Lavdëron zhvillimin që pësoi Sziraku gjatë viteve të kaluara, dhe përmend me krenari rolin kryesues të Forever-it. Bën të njohur gjendjen e Forever-it dhe tregon plane bindëse. Rreth rrugës drejt suksesit thotë: Sukesi qëndron përpara punës vetëm në një vend, në fjalorin anglez. Në gjithçka tjetër është puna që e papaprin suksesin! Mund të keni sukses vetëm nëse punoni për të dhe e dini se ku po shkoni!"

Ndërmjet leksioneve profesionale u argëtuam nga shfaqja e artistëve **Gabriella Berkes, Oliver Berkes, Nikoletta Füredi dhe Denes Kocsis**.

Mbyllëm një ditë të veçantë më 5 qershor në Szirak. Morrëm një program profesional me nivel të lartë, si dhe na u dha mundësia të shihemi me shumë kolegë të ardhur nga larg.




DAVIDSON

Hotel Kastély SZIRÁK



## TRAINIME GRUPESH FLP-JE

***Ofertë me ulje çmimi***

*strehim për 2 ditë,1 natë dy vakte kryesore (drekë, darkë),*
*mëngjes me tryezë suedeze shërbimet bazë të sektorit SONYA wellness*
*(sauna, kabinë kripe, pishina me rrymë të kundërt, xhakuzi)*
*përdorim i fushës së tenisit*

***15.000.-Ft/person***

*Në sektorin SONYA punonjësit e FLP-s mund*
*të marrin në përdorim edhe trajtime të ndryshme kozmetike dhe masazhe me 50% ulje çmimi!*

*Trainimet organizohen në sallën Ovidius.*
*Rregullimi i orendive dhe pajisjeve teknike*
*bëhet sipas kërkesave të porositësit.*



tel.: 06 32 485 300 www.kastelyszirak.info

mail: info@kastelyszirak.info

FOREVER RESORTS

PHŐNIX
BUDAPEST KFT.
AGJENSI BILETASH AVIONI

IATA Accredited Agent

AXA másképp / mint mások



**ZSUZSANNA GERŐ**
Prenotime në grup
rally

**Kontaktim:**
1183 Budapest, Nefelejcs u 9–11.
Tel: +36 1 269 5370/158
Mobil: +36 70 436 4272
e-mail: rally@flpseeu.hu



**GABRIELLA PITTMANN**
Prenotime personale

**Kontaktim:**
1067 Budapest, Szondi u. 34.
Tel: +36 1 373 0025
Mobil: +36 70 436 4297
e-mail: repjegy@flpseeu.hu

PRENOTIM I THJESHTË BILETASH AVIONI PËR NË ÇDO VEND TË BOTËS

www.phonixrepjegy.info

# Success Day

## PËRVJETORI I NJË FAMILJE TË MADHE



**FAMILJA E MADHE E FOREVER-IT PREJ DISA JAVËSH ME NJË TENSION TË KËNDSHËM PËRGATITET PËR FESTIMIN E DENJË TË PËRVJETORIT TË SAJ TË TREMBËDHJETË. PËR FESTIMIN E DENJË NEVOJITEN EDHE NJERËZ TË DENJË: MES TYRE DO TË JETË KRIJUESI I SHOQËRISË SONË, PRESIDENTI I KËSHILLIT DREJTUES, REX MAUGHAN, DREJTORI I EUROPËS AIDAN O’HARE, SI DHE DREJTORI OPERATIV I EUROPËS PETER LENKEY.**





Duke parë listën e emrave s'është çudi që u përhap shumë lajmi i këtij aktiviteti. Në Arenë shikohet një turmë e madhe, e paparë ndonjëherë! Skena gjallërohet kur shfaqen drejtuesit e aktivitetit – senior menaxherët **Tünde Hajcsik, Patricia Rusak**, dhe soaring menaxherja **Diana Biro** – dhe bëjnë hapjen e tij duke i përshëndetur të pranishmit në disa gjuhë të ndryshme. Me këtë rast kanë ardhur jo vetëm mysafirë hungarez, serb, kroat, slloven dhe shqipëtar, por edhe sllovak, rumun, çek, rus dhe polak, madje edhe disa prej Suedisë. Drejtori gjeneral **Dr. Sandor Milesz** duartrokitet prej më shumë se dymbëdhjetë mijë duar kur shfaqet ne skenë. Fjalët e tij të para janë fjalë ngushëllimi. Kujton ata të cilët tani afër u dëmtuan nga katastrofat natyrore në rajon, pastaj deklaroi se Forever dha ndihma për të dëmtuarit nga përmbytja. Thotë që ka nga ata që jo vetëm flasin, por edhe veprojnë për parimet e tyre. Pas kësaj edhe ai i përshëndeti në disa gjuhë mysafirët, pastaj bashkë me safir menaxherin Jozsef Szabo i urojnë duke kënduar gëzuar përvjetorin Forever-it. Kur e fillojnë për herë të dytë me ta bashkohet edhe publiku.



Drejtori Operativ i Europës **Peter Lenkey** me dinamizmin e tij të zakonshëm vjen duke vrapuar drejt mikrofonit. Ai përshëndet jo vetëm të pranishmit dhe mysafirët e rangut të lartë, por nuk harron as shtabin që punon prapa skenës. Flet rreth gjendjes së tregut, dhe jo me letargjinë e zakonshme të tanishme – për këtë s'ka as shkak, pasi Forever jo vetëm rritet, por vitin e kaluar solli të ardhura të larta. Siç thotë Lenkey, gjithë kjo vjen nga njëra anë falë bashkimit të kombeve, i cili në mënyrë të pavetëdijshme bën më shumë për paqen e rajonit dhe pranimin e njëri tjetrit se sa çdo program tjetër që ka qëllim të tillë. Radhit fakte të tjera bindëse nga plani i zhvillimit, prezanton hollësisht përshembull faqen e internetit të rinovuar plotësisht si në pamje edhe në përmbajtje. *„Mos lejo që koha të kaloj kot!"*- thotë ai.
















Fjalën e merr **Dr. Sandor Milesz** dhe deklaron një lajm tepër të rëndësishëm: shpall nisjen e programit Forever Telefon. Aparatet e para u jepen presidentit të FLP International Inc. **Rex Maughan** dhe drejtorit të Europës **Aidan O'Hare**. Nis një sulm i vërtetë thirrjesh: turma të tëra përgëzojnë mysafirët e rangut të lartë, atmosferën për të cilën e siguron **grupi Danyi Mazsorett**. Vetëm pas kësaj bëhet e ditur që katër telefonuesit e parë marrin dhuratë nga një aparat celular.

Në skenë shfaqet soaring menaxherja dhe anëtarja e President's Club, **Dr. Ilona Juronics Vargane**, burimi i pashtershëm i njohurive rreth produkteve. Dëgjojmë një leksion të ilustruar në mënyrë kreative, intenziv nga ana profesionale, por tepër të qartë rreth mënyrës se si mund ta mbrojmë organizmin tonë gjatë periudhës së pushimeve verore.
Njohuritë e shumta shkencore ndërprihen nga pak argëtim: vjen raundi i ri i konkursit të zbulimit të talenteve me titull "Yjet e Forever-it". Por për disa njerëz edhe kjo është një detyrë plot përgjegjësi: **Karoly Horvath**, drejtori i sallonit Karinty dhe projekt-menaxheri artistik i Teatrit Kombëtar është i pranishëm si kryetari i jurisë. Me anëtarët konstant të jurisë, artisten dhe këngëtaren **Gabriella Berkes** dhe koreografin **Akos Tihanyi**, me këtë rast bashkohet edhe artistja dhe anëtarja e Teatrit Operet të Budapestit **Aniko Felföldi** dhe legjenda e rrokut **Attila Pataky**. Pas shfaqjeve me drejtimin e **Dr. Endre Nemeth** këshilltarët dhe punonjësit mjek të Forever-it tregojnë përvojat e tyre me produkte në praktikë. Tregon **Dr. Gabriella Kassai, Dr. Edit Revesz Siklosne, Dr. Brigitta Kozma dhe Dr. György Bekanek**. Është një siguri për ne që mund të mbështetemi tek njohuritë e tyre!

Ata pasohen nga njeriu, aura e të cilit e mbush skenën gjithmonë plot: **Aidan O'Hare** na përshëndet me fjalë të ngrohta. Përshëndet në mënyrë të veçantë ata që marrin pjesë







për herë të parë në aktivitetin Forever. Me fjalë të thjeshta – të përkthyera nga **Dr. Sandor Milesz** – i nxit të gjithë për krijimin e vizionit dhe realizimin e pikësynimeve të veta. *"Besoj se e ndjeni dashurinë dhe vlerësimin tonë! Kjo është një firmë e mirë! Asnjëherë s'kemi qenë më të mirë se tani! Asgjë tjetër s'ka rëndësi përveç asaj që mund të bëni ju"* – thërret ai.

Është një rast i jashtëzakonshëm kur të kualifikuarit i marrin medaljet e tyre nga **Rex Maughan**, personi që e solli në jetë idenë e Forever-it, **Aidan O'Hare** dhe **Peter Lenkey**, ndërkohë që thirren personalisht nga **Dr. Sandor Milesz**. Një turmë e vërtetë supervizorësh dhe asistent menaxherësh rreshtohen me emocion. Safir menaxheri dhe distributori më i vjetër i Europës Lindore **Jozsef Szabo** tregon rreth ëndrrës e cila e nisi atë përpara pesëmbëdhjetë vitesh në rrugën të cilën sot e konsideron si mision jete.

Pas kësaj në skenë shfaqet vetë forca bindëse nëpërmjet një nga figurave më vendimtare të ndërtimit të rrjetit, safir menaxherit dhe anëtarit të President's Club, **Dr. Adolf L. Kosa**. Adolf ka ndërtuar një nga skuadrat më të mëdha me një numër të madh menaxherësh gjatë karrierës së tij prej një dhjetëvjeçari në FLP. Kur bëhet fjalë rreth ndërtimit të skuadrës, ai është me siguri specialisti i kësaj. Këtë njohuri na e përcjell neve këtu në mënyrë shumë autentike. Skena ndryshon duke marrë një pamje të veçantë. Përpara nesh shfaqet një sallon kozmetik: pason **Sonya Show**, *"tregëti në tregëti"*. Në produktet kozmetike të Forever-it fshihen mundësi të shumëfishta, duke u nisur që nga bukuria dhe shëndeti, deri tek vetëbesimi, "aroma e pavarësisë" dhe qëndrimi i sponsorueshëm, kur prezantohen nga drejtueset e bukura të shfaqjes. Prezantimi plotësohet nga shfaqja spektakolare e **Grupit Muzikor dhe Kërcimtar Android**. Duartrokitja e mëpasshme i drejtohet një personaliteti të njohur në shkallë ndërkombëtare të ndërtimit të rrjetit, safir menaxherit **Istvan Halmi**. Anëtari i President's Club, udhëtari "i përhershëm" i Rally-ve, pa të cilin programet motivuese janë të paimagjinueshme. *"Të mendojmë së bashku rreth Poreçit!"* – thotë. Duke dëgjuar atë e ndjejmë pothuajse në gojë shijen e mëngjeseve plot gjallëri të Poreçit, pamjen e bregdetit – është e paimagjinueshme që të ekzistoj ndonjë njeri të cilit nuk i lindi dëshira të kualifikohet për në Holiday Rally.











Më pas në skenë shfaqen përsëri "Yjet e Forever-it". Ne e shijojmë shfaqjen, ndërkohë që juria mendohet, peshon, shikon me vëmendje dhe vlerëson.

Aktiviteti vazhdon me kualifikime. Të parët që marrin çertifikatat vlerësuese janë anëtarët e President's Club. Ata ndiqen nga të kualifikuarit e **Klubit të Sundimtarëve** nga çdo vend i rajonit, pastaj vijnë menaxherët, senior dhe safir menaxherët nga brenda dhe jashtë kufijve. Nuk mbeten jashtë as të kualifikuarit e Programit Motivues të Makinës dhe anëtarët e Business Builder's Club. Të marrësh vlerësim nga dora e Rex Maughan dhe Aidan O'Hare është një nder i jashtëzakonshëm. Ndriçimi i njëkohshëm i bliceve është si ndriçim triumfi i skenës!
Lektorja e mëpasshme thirret në skenë me subjektivitetin e zakonshëm. Anëtarësinë e pathyeshme prej vitesh të tëra në President's Club dhe skuadrën e saj të madhe ndërkombëtare diamant-safir menaxherja **Aranka Vagasi** e krijoi me stilin e saj të vendosur që ua përcjell të tjerëve. Kur flet rreth vlerave të Profit Sharing na bën të shikojmë vlera njerëzore pas çeqeve. Tregon rrugën dhe jep shembull rreth lojalitetit, njerëzisë dhe respektit duke ecur gjithmonë përpara. Publiku duartroket një drejtuese me njohuri dhe përvojë të madhe.
Numri gjithmonë e më i madh i flamujve kroat tregon që: Dr. Sandor Milesz thërret në skenë të kualifikuarit e **Holiday Rally**-t.
Dhe sa i rëndësishëm është zhvillimi personal, këtë e vërteton diamant-safir menaxheri dhe anëtari i President's Club, **Robert Varga**. Me një entuziazëm që të bën për vete na udhëheq në praktikën e përditshme të ndërtimit të rrjetit. Na tërheq vëmendjen për mjetet me të cilat zhvillimi është i arritshëm për të gjithë. Pas kësaj drejtuesi artistik **Zsolt Frenko** transmeton vendimin e jurisë në konkursin Yjet e Forever-it. Publiku e shpreh me duartrokitje të mëdha mendimin e njëjtë me jurinë.
Pasojnë kualifikime të reja: prezantohen distributorët e kualifikuar për në Super Rally. Diamant-safir menaxheri dhe anëtari i President's Club **Miklos Berkics** është shembulli dhe njëkohësisht ndjekësi i përsosur i standardit që ngriti dhe mban lart deri më sot Forever-i. Gjithë bota mrekullohet nga rezultatet që skuadra e madhe dhe numri i madh i menaxherëve të tij arrijnë nga viti në vit. Sukseset e trembëdhjetë viteve vërtetojnë që Forever-i është mundësia, shfrytëzimi i të cilës varet vetëm nga vendosmëria e individit. *"Mos u bë kotele që mjaullin vazhdimisht, por bëhu luan trim!"* – u thotë të gjithëve. Radha e leksioneve profesionale mbyllet nga diamant menaxherja e vetme dhe anëtarja e President's Club, **Lomjanski Veronika**. Pritet me brohoritje dhe duartrokitje të mëdha. *"E dëshiron apo jo?"* na e drejton ne pyetjen që vendos gjithçka. "Nëse









dëshiron të jetosh më mirë, bashkohu me një skuadër të tillë!" – na këshillon dhe na tregon argumentet e veta. Tregon rreth periudhave të vështira, por mendon se rëndësi ka vetëm ajo që njeriu dëshiron me të vërtetë. Jeta dhe karriera e saj është shembull i mënyrës se si mposhti largësinë, kufijtë, luftën dhe gjithçka që i doli përpara.



Në gjithë ditën që gumëzhinte nga gëzimi ndoshta momenti i vetëm i heshtur nga emocioni është kur në skenë shfaqet **Rex Maughan**. Me vëmendje të tendosur presim mesazhin e njeriut i cili sot pavarësisht se mund të pushonte kudo në botë në ndonjë vend pushimi lluksoz, prapë zgjodhi të jetë këtu me ne, në dispozicionin tonë për çdo lloj pyetje, shtrëngim duarsh apo një fotografi të përbashkët. Ndërkohë që në fytyrën e tij shihet gjithmonë buzëqeshja dhe durimi zemërmirë. *"Dëshiroj t'ju them disa gjëra rreth botës, që ta shikoni se si do të zhvillohemi. Si do të bëheni diamant."* – fillon fjalën e tij, pastaj tregon rreth zhvillimeve premtuese ekonomike. Kur kudo të gjithë flasin rreth recesionit. Presidenti shpreh besimin e tij në faktin që qarkullimi europian ndodhet në prag të zhvillimit të madh. Tregoi shkurt njësinë e re prodhuese me emrin Forever Nutraceuticals, ku përgatiten produkte në formë tablete. *"Dëshirojmë t'i ndihmojmë njerëzit në shumëllojmënyrash – thotë – dhe dëshiroj ta dalloni që këtë duhet ta bëjmë në mënyra të ndryshme. Mos i besoni askujt që dyshon tek ju. Ta dini që mund të arrini gjithçka nëse dëshironi!"* Si përfundim Dr. Sandor Milesz falenderon drejtuesit e programit dhe lektorët që ngritën nivelin e aktivitetit, dhe thërret në skenë dhe prezanton shtabin organizues duke vlerësuar me këtë punën e tyre.






SAPPHIRE




WORLD RALLY 2010
FOREVER
MIKLOS


Success Day
2010.június 6.


Success Day


















Success Day







# *E dashur Shqiponjë e Re!*

*Të përshëndes me respekt dhe dashamirësi Ty që tani hyre në një firmë të vërtetë botërore. Të përgëzoj për vendimin tënd! Tregoja pa frikë të gjithëve. E di që mund të zgjidhje edhe nga produktet e firmave të tjera, mund të nisje biznes edhe në fusha të tjera ose me firma të tjera MLM.*

*Sa shoqëri, kompani apo firma MLM do të çonin me qindra e mijëra punonjës të saj çdo vit në udhëtime lluksoze vetëm për faktin se ata bënë diçka me të cilën i siguruan të ardhura të rregullta dhe të ardhme të sigurt vetvetes dhe familjes së tyre (dhe jo punëdhënësve!)?*

*Edhe Ti ishe tani në qershor në Poreç? Nëse po, atëherë e kupton përse nuk mund të tregoj në mënyrë objektive rreth tij. Është e vështirë të gjesh fjalët, është pothuajse e pamundur të përshkruash pa subjektivitet mbresën dhe ndjenjën e veçantë që ndodh aty me ne prej disa vitesh. Holiday Rally – i cili u ëndërrua katër vjet më parë nga Dr. Sandor Milesz – sot është koncept i veçantë dhe me famë botërore: unitet-motivim-trainim-miqësi-pushim-argëtim-larmi.*

*Nëse ti nuk ke qenë akoma në Poreç, atëherë po të pyes: ka ndodhur ndonjëherë me ty në jetë diçka shumë e mirë, fantastike, që të lë pa frymë? Doje që këtë ta dinin të gjithë, ishte tepër entuziast, u përpoqe t'ua tregoje miqve të tu, por kuptove që është e pamundur t'i përcjellësh me fjalë çështjet e zemrës – thjesht nuk mund t'i tregosh dot ato që ke përjetuar?*

*Po vjen me ne edhe për herë të dytë – apo kjo është hera e parë për ty? Aq më mirë! Herën e parë e mbajnë mend të gjithë… Shiko vetveten: TI PIKËRISHT TANI VENDOSE, dhe deri në 31 gusht E REALIZON PLOTËSISHT EDHE SI I RI! Në shtator, në Holiday Rallyn e dytë të pret mrekullia e pafund e detit Adriatik, me të cilën nuk ngopemi prej vitesh.*

*Programi motivues gjenial i Dr. Sandor Milesz-it, një projekt i veçantë në nivelin e supervizorit, është një ofertë ushqimi-pije-wellness me nivel botëror, all inclusive, 24 orësh, me 4 yje, një mikpritje dhe organizim profesionist me 5 yje në të gjitha aspektet nga drejtori rajonal i Forever Kroacisë Dr. Laszlo Molnar, elita ndërkombëtare e menaxherëve, skuadra me 6 yje e lektorëve që punojnë në nivelin më të lartë dhe Forever Feeling me 7 yje!*

*Ndoshta edhe ti bashkë me partneren tënde mund të paguani pa problem 700-800 euro për një pushim të tillë 3-4 ditor në bregdet. Ndoshta juve nuk ju intereson arritja e nivelit 25 pikësh i supervizorit, sepse tani nuk ju mungojnë në jetë të ardhurat mujore prej 400-800 eurosh.*

*Atëherë përse do ta realizosh? Për gjërat të cilat nuk mund t'i blesh kurrë me para. Mund të kesh para për pushime, mund të udhëtosh kudo, në asnjë vend nuk të presin mijëra miq, dhjetëra mijëra përqafime dashamirëse, qindra mijëra puthje dhe miliona yje në qiellin e Adriatikut.*

*Tani do të jetë ndryshe rëra e nxehtë dhe drita e hënës. Përqafon partneren tënde në natën magjepse mediterrane të Forever-it. Zgjati duart drejt yjeve… TANI E ARRIN, DO TË BËHET I YTI… në Poreç ndodhin gjithmonë mrekulli.*

**Tibor Radoczki**
SOARING MENAXHER,
DREJTOR RAJONAL



BEOGRAD, 29 MAJ 2010

# Success Day

**Kur një firmë ndodhet prej tridhejtë e dy vitesh në tregun botëror, kjo do të thotë që ajo ofron cilësi, profesionizëm, besim dhe kënaqësi. Këtë bën edhe firma jonë Forever Living Products, përvjetorin e të cilës a festojmë në muajin maj.**

Drejtuesit e aktivitetit të përvjetorit ishin një nga çiftet më të mira kërcimtare të FLP-s, senior menaxherët **Olga dhe Miodrag Ugrenović**. Ata kanë kuptuar prej kohësh konceptin e tregëtisë private, dhe në Forever panë mundësi të mëdha, punë të shkëlqyer, miq të shumtë dhe udhëtime të paharrueshme.





Drejtori rajonal i FLP Serbisë **Branislav Rajić** i përgëzoi të gjithë me rastin e përvjetorit të firmës sonë dhe bëri të njohur informacionet e reja. Dëgjuam lajme të shumta të cilat e lehtësojnë akoma më shumë ndërtimin e rrjetit. Produktet e reja, ndryshimet në Planin Marketing dhe programet e shumta motivuese i japin një vrull akoma më të madh veprimtarisë sonë. „Në ditët tona FLP është mundësia më e mirë e punës në Serbi për tregëtarët privat!" – theksoi drejtori rajonal Rajić.

Produktet tona të shkëlqyera ndjekin tendencat e tregut botëror, kurse me cilësinë e tyre qëndrojnë shumë lart në krahasim me produktet e ngjashme të firmave konkurente. Falë kësaj FLP luan rol drejtues në tregun e plotësuesve ushqimor. Falë produkteve tona të reja – të cilat na i prezantoi menaxherja **Siniša Blašković** – kudo në botë kemi gjithmonë e më shumë konsumatorë të kënaqur.



Në World Rally takohen distributorët më të mirë të FLP-s në botë. Jemi shumë krenar që edhe në këtë aktivitet nuk mungonin përfaqësuesit serb. Në World Rallyn e Brazilit distributorët tanë më të suksesshëm, diamant menaxherët **Veronika dhe Stevan Lomjanski** e përfaqësuan përsëri në mënyrë të denjë vendin tonë. Treguan se u përkasin distributorëve drejtues të Forever-it! E falenderojmë Stevan-in për tregimin e hollësishëm me të cilin u solli përpara atmosferën e mrekullueshme të rallyt brazilian distributorëve të mbledhur në Pallatin e Sindikatave.



Trupi i njeriut është pjesë bazë e sistemit energjitik ku jetojmë. Mënyra moderne e jetesës e thyen gjithmonë e më shumë harmoninë e trupit tonë, shpërbën ekuilibrin e proceseve fiziologjike dhe me kalimin e kohës shfaqen simptoma gjithmonë e më të këqija. Këtë mund ta parandalojmë nëse e ruajmë vazhdimisht ekuilibrin ndërmjet natyrës dhe trupit tonë. Produktet e FLP-s kontribojnë shumë në ruajtjen e jetesës së shëndetshme dhe cilësore, prandaj t'i përdorim ato rregullisht dhe t'ua rekomandojmë edhe të tjerëve! Soaring menaxherja dhe specialistja mjeke e FLP-s **Dr. Biserka Lazarević** shpjegoi shumë mirë lidhjen e ngushtë ndërmjet produkteve tona dhe ushqimit cilësor.









Efekti parandalues i produkteve tona ndihet nga punonjësit tanë mjek gjatë punës së tyre të përditshme, si edhe nga konsumatorët. Senior menaxheri **Dr. Olivera Miškić** foli me një profesionizëm të madh rreth kësaj, pastaj erdhi kualifikimi i supervizorëve dhe asistent menaxherëve të rinj. U urojmë të gjithëve punë dhe karrierë të suksesshme në FLP!

Këngëtari **Igor Starović** sjell prej vitesh të tëra një atmosferë të shkëlqyer në aktivitetet tona. Shfaqja e tij edhe tani nuk la asnjëri pa ndikuar, të gjithë u ngritën në kërcim.

„Ti je me të vërtetë një njeri nëpërmjet të cilit dikush bëhet i veçantë." – tha në leksionin e tij menaxheri **Milan Mitrović Pavlović**. Ne jemi me të vërtetë njerëz të veçantë, kryesisht kur dëshirojmë t'i sigurojmë vetes punë dhe jetë të suksesshme, dhe bëjmë gjithçka për këtë gjë. Nuk ekziston njohuri të cilën nuk mund ta shfrytëzojmë, sidomos kur këtë e bëjmë me një mjet si TOUCH. Parimi i FLP-s është që përpiqet të bashkëpunoj me njerëz të suksesshëm, që kanë vizion dhe dëshirë për të vepruar, me njerëz të cilët bëjnë gjithçka për përmirësimin e jetës së vet dhe njerëzve që jetojnë në mjedisin e tyre.

Përgëzuam anëtarët e Klubit të Sundimtarëve të cilët e kanë rritur shumë qarkullimin e tyre në krahasim me periudhën e mëparshme. Bëmë vlerësimin e gjithë punonjësve asistent supervizor të cilët gjatë muajit të kaluar në rrjetin e tyre arritën të paktën 1 pikë personale dhe 5 pikë distributori.

Jemi shumë krenar për suksesin e safir menaxheres **Danijela Ocokoljić**, e cila në bazë të rendimentit të saj gjatë vitit 2009 e meritoi të përfaqësoj Serbinë mes anëtarëve të klubit Business Builders.











Kontrata e punës me FLP-n hap dyer të shumta drejt botës së tregëtisë. Me Planin Marketing konsekuent dhe ndihmën e sponsorëve tanë na jepet një mundësi e pafund. Senior menaxherja **Milanka Milanović** është specialiste e shkëlqyer e punës FLP, falë të cilës e përshkroi në mënyrën më të mirë rrugën e vetme fitimtare: ndërtimin e metalitetit fitimtar të skuadrës.

Edhe sivjet në gusht do të kemi përfaqësuesit tanë në aktivitetin ndërkombëtar Super Rally të Denverit. Gjithë kolegët tanë të kualifikuar do të kalojnë disa ditë të paharrueshme në Shtetet e Bashkuara.

„Do të isha vetëm njeri i zakonshëm po të mos ndryshoja mënyrën e të menduarit. Pavarësisht nga vështirësitë e fillimit më ndoqi një skuadër e përbërë prej punonjësish të sinqertë dhe besnik, me të cilët bashkëpunuam në mënyrë të hapur e të ndershme. Në aspektin e cilësisë së produkteve, mënyrës së qarkullimit dhe llogarisë së bonusave Forever i lë pas vetes të gjitha firmat e tjera konkurente. Këto përparësi ofrojnë një mundësi të madhe!" – tha në leksionin e saj diamant menaxherja **Veronika Lomjanski**.

Asistent supervizorët e rinj arritën shkallën e parë në Planin Marketing të FLP-s. Për punën e tyre të vullnetshme u dhuruam medaljen me shqiponjë, simbolin e forcës, pathyeshmërisë dhe këmbënguljes. Ua urojmë edhe atyre këto tipare.

**Branislav Rajić,**
**Drejtori rajonal i FLP Serbisë**







# *Jetë e përhershme*

# GINKGO BILOBA



**Ka 200 milion vjet, që në kohën e dinosaurëve, që ekziston kjo bimë e lashtë e cila deri më sot s'ka ndryshuar aspak, dhe nëpërmjet udhëtarëve të mëdhenj të botës u kthye përsëri në Europë. Ginkgo biloba është një mundësi jetese! Ta mendojmë mirë: ka përjetuar të gjitha katastrofat e tokës. Është imune ndaj çdo efekti dëmtues të mjedisit, përthith edhe gazrat e shkarkuara, dhe jeton edhe 1000 vjet. Një nga llojet më të vjetra gjendet në Utrecht. 22 metra e lartë, trungu i të cilës e ka diametrin 4 metra. Pas shpërthimit të bombës atomike në Hiroshimë, bima e parë që çeli ishte Ginkgo…**

Mjekësia kineze e përdor prej 3000 vitesh gjethen e Ginkgo-s për mjekimin e astmës, sëmundjeve të bronkeve dhe mushkrisë. Dokumenti i parë rreth efektit të saj mjekues i përket periudhës së dinastisë Ming. Lan Mao në punën e tij të shfaqur në vitin 1436 e rekomandon për përdorim nga jashtë, kryesisht për mjekimin e plagëve dhe qukave, Liu Ventai dhe të tjerë në shkrimin me titull Ben Cao Pin Hui Jing Yao të shfaqur në vitin 1505 e rekomandon Gunkgo-n për mjekimin e heqjes së barkut, dhe e quan „mirëbërës i trurit". Kurse Li Shinzen në „Librin e Barnave" të publikuar në vitin 1596 përmbledh rezultatet e deriatëhershme, dhe këtë bimë e radhit mes shtuesve të oreksit, përmirësuesve të tretjes, dhe lëndëve stimuluese të sistemit nervor qendor, kurse përdorimin nga jashtë e rekomandon për mjekimin e kataraktit.

Kërkimet e viteve të fundit bëjnë të qartë rolin e prostaglandinës në agregimin e trombocitave (grumbullimin e pllakëzave të gjakut), dhe nëpërmjet kësaj në procesin e krijimit të trombozës. Në membranën e pllakëzave të gjakut nga enzima krijohet endoperoxyd i paqëndrueshëm. Prej tij në pllakëzat e gjakut krijohet thromboxan A2. Thromboxan A2 është lëndë që shkakton tkurrjen e enëve të gjakut (vasoconstrictor) dhe agregim të trombocitave, pra ndihmon krijimin e trombozës. Në murin e enëve të gjakut gjatë krijimit të prostaglandinës nga endoperoxydi i paqëndrueshëm krijohet prostacyclin, e cila është lëndë që zgjeron enët e gjakut dhe shton elasticitetin e rruazave të kuqe të gjakut. Prostacyclina njëkohësisht pengon grumbullimin e pllakëzave të gjakut. Faktori rritës i trombocitave (PAF) që sekretohet nga pllakëzat e gjakut shkakton shtimin e qelizave endoteliale në murin e enëve të gjakut, nëpërmjet të cilës ndihmon krijimin e thrombozës. Si efekt i këtij faktori shtohen qelizat e muskulit të lëmuar të murit të enëve të gjakut, duke shkaktur nëpërmjet kësaj ngushtimin e enëve të gjakut (arteriosklerozë). Ky proces dëmton sistemin imunitar, duke nisur në këtë mënyrë proceset alergjike, dhe mund të shkaktoj shok toksik. Efekti i kundërt i thromboxanit dhe prostacyclinës mban ekuilibrin e elementëve përbërës të gjakut.

Ekstrakti i gjethes së Gunkgo-s shton krijimin e prostacyclinës, pengon efektin e PAF dhe peroksidimin e lipideve (marrjen e oksigjenit nga qelizat dhjamore), nëpërmjet të cilës ulet rezistenca e fërkimit ndërmjet qelizave të gjakut (viskoziteti), rritet elasticiteti i rruazave të kuqe të gjakut, ato bëhen më të qëndrueshme ndaj shkatërrimit, dhe përmirësohet qarkullimi i gjakut edhe në kapilarë. Në këtë mënyrë, nëpërmjet rregullimit të ekuilibrit thromboxan-prostacyclin ulet mundësia e krijimit të ëdemës, kapilarët zgjerohen dhe shtohet depërtueshmëria (permeabiliteti) i tyre. Si rrjedhim përmirësohet furnizimi me gjak i indeve.

Ekstrakti Ginkgo nëpërmjet efektit antioksidant (pengimi i peroksidimit të lipideve) shton në inde, sidomos në indin e trurit marrjen dhe përdorimin e oksigjenit dhe glukozit, dhe në këtë mënyrë përshpejtohet rigjenerimi i qelizave të trurit. Pra deri në një farë mase kjo lëndë mbron edhe kundër hipoksisë (mungesës së oksigjenit) së trurit. Gjatë peroksidimit të tepërt të lipideve krijohen edhe radikale të lira të cilat shkaktojnë dëmtimin e mureve të qelizave, me këto kjo lëndë është e aftë të lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Efekti i favorshëm në organizëm krijohet nga këto mekanizma së bashku, i cili shfaqet kryesisht në përmirësimin e mikrocirkulacionit (qarkullimit të gjakut në enët më të vogla të gjakut) të trurit dhe gjymtyrëve.

Në vitin 1969 treguan që radikalet e lira gjenden në qelizat e gjalla: energjinë e krijuar gjatë djegies së oksigjenit organizmi e përdor për kryerjen e detyrave të qelizave. Gjatë proceseve të djegies atomet e oksigjenit humbasin një pjesë të elektroneve, kështë që nga këta dhe hidrogjenet krijohen radikalet e lira. Nëse organizmi nuk ka afëtsinë e duhur mbrojtëse kundër tyre, kjo sjell shkatërrimin e qelizave – kryesisht të qelizave të trurit.

Krijimi i shumtë i radikaleve të lira është i mundshëm në rastin e uljes së qarkullimit të gjakut (ischaemia), marrjes së oksigjenit nga qelizat dhjamore, dhe si rrjedhim i efekteve dëmtuese të jashtme (ndotja e ajrit, rrezatimi).

Ginkgolid është i aftë të bëj lidhjen e radikaleve të lira. Ky është mekanizmi i efektit antioksidant, ku përveç ginkgolidit B të quajtur edhe bioflavonoid, luajnë rol edhe vitaminat C dhe E, si dhe disa enzima.
Për punën kërkimore të efektit të barnave nevojitet një lëndë vepruese me sasi të përcaktuar. Në rastin e Ginkgo-s këtë e përcaktuan në vitin 1989 në Gjermani, dhe e patentuan me shenjën EGb 761. Përmban: 24% glikozidat flavonoidi dhe 6% terpenoid.

EGb 761 efektin më të madh e jep në ndihmën e funksionit sistemin nervor të njeriut. Truri që përbën 2% të peshës së trupit ka nevojë për 20% të gjakut që qarkullon në mënyrë që të funksionoj në rregull. Kjo sasi i siguron oksigjenin dhe lëndët ushqyese të nevojshme për metabolizimin e qelizave nervore. Për këtë qarkullim gjaku nevojitet një sistem enësh gjaku që funksion pa pengese.
Me rritjen e moshës ulet rendimenti i trurit, sepse qarkullimi i gjakut të trurit (microcirculacio) bëhet i pamjaftueshëm dhe prandaj dëmtohet furnizmimi me oksigjen dhe metabolizmi i qelizave nervore. Si pasojë e qarkullimit të keq të gjakut shfaqen simptomat e para të pamjaftueshmërisë të trurit, funksionet kognitive: fillon të ngadalësohet mësimi, vigjilenca, vëmendja, aftësia për të kuptuar. Krijohen simptomat e fillimit, pastaj ato më serioze të demencës, dhe si përfundim simptomat kryesore të sëmundjes Alzheimer. Por simptomat e krijuar mund të zbuten me lëndë që ndihmojnë oksigjenizimin dhe përdorimin e glukozës në tru. E tillë është edhe Egb 761. Mjekët kërkues kanë kryer studime eksperimentale të gjera me grupe kontrolli të dyfishta qorre për vërtetimin e vlerës terapike të Egb 761. Këto janë rezultatet:

## ZBULIMI

Ginkgolid u izolua nga gjethja e ginkgos në vitin 1932 nga japonezi Furakava. Në vitin 1988 Corey me çmim Nobel dhe bashkëpunonjësit e tij (Harward) bënë ndarjen e elementëve përbërës të Ginkgolid, të cilava u dhanë shenjat A, B, C, G, J dhe M.

## LËNDËT VEPRUESE

1., Flavonoidët (40: Kaempferol (mono.), Quercetin (di-), Isorhamnetin (triglicosida), Cumarsav (flavonolglucosida) janë më rë rëndësishmit.

2., Terpenët (6): janë për t'u theksuar Ginkgolid (diterpen) dhe Bilobalid (sesquiterpen). Këto dy lëndë gjenden vetëm tek Ginkgo biloba.

## LITERATURA

(1)Adams LL, Gatchel RJ, Gentry C. Complementary and alternative medicine: applications and implications for cognitive functioning in elderly populations. Altern Ther HealthMed. 2001;7(2):52-61. (2)Bastianetto S, Ramassamy C, Dore S, et al. The Ginkgo biloba extract (Egb 761) protects hippocampal neurons against cell death induced by beta-amyloid. Eur J Neurosci 2000;12:1882-990. (3)Cheuvront, S. N. and Carter, R., III. Ginkgo and memory. JAMA. 2-5-2003;289(5):547-548. (4)Drew S, Davies E. Effectiveness of Ginkgo biloba in treating tinnitus: double blind, placebo controlled trial. BMJ. 2001;322(7278):73. (5) Ernst E, Canter PH, Coon JT (2005). “Does ginkgo biloba increase the risk of bleeding? A systematic review of case reports”. Perfusion 18: 52–56. (6) Hopfenmüller W. Nachweis der therapeutischen Wirksamkeits eines Ginkgo biloba-Spezialextraktes. Meta-Analyse von 11 Studien bei Patienten mit Hirnleistungsstörungen im Alter. Azneim.-Forsch./Drug Res 1994;44:1005-13. (7) Horsch, S. and Walther, C. Ginkgo biloba special extract EGb 761 in the treatment of peripheral arterial occlusive disease (PAOD)--a review based on randomized, controlled studies. Int.J Clin Pharmacol Ther. 2004;42(2):63-72. (8) Huang, S. Y., Jeng, C., Kao, S. C., Yu, J. J., and Liu, D. Z. Improved haemorrheological properties by Ginkgo biloba extract (Egb 761) in type 2 diabetes mellitus complicated with retinopathy. Clin.Nutr. 2004;23(4):615-621. (9)ITIL TM, Eralp E.; Tsambis E., ITIL KZ, Stein U. 150 White Plains Road, Tarrytown, NY 10591 USA American Journal of Medicin (USA), 1996, 3 / 1 (63-73) (10)Johnson SK, Diamond BJ, Rausch S, Kaufman M, Shiflett SC, Graves L. The effect of Ginkgo biloba on functional measures in multiple sclerosis: a pilot randomized controlled trial. Explore (NY). 2006;2(1):19-24. (11)Kanowski S, Herrmann WM, Stephan K, et al. Proof of efficacy of the Ginkgo biloba special extract Egb 761 in outpatients suffering from mild to moderate primary degenerative dementia of the Alzheimer type or multi-infarct dementia. Pharmacopsychiatry 1996;29:47-56. (12)Kenney C, Norman M, Jacobson M, and et al. A double-blind, placebo-controlled, modified crossover pilot study of the effects of Ginkgo biloba on cognitive and functional abilities in multiple sclerosis. American Academy of Neurology 54th Annual Meeting. April 13-20 2002;P06.081. (13) Kim YS, Pyo MK, Park KM, et al. Antiplatelet and antithrombotic effects of a combination of ticlopidine and Ginkgo biloba ext (EGb 761). Thromb Res. 1998;91:33-38. (14) Kohler, S., Funk, P., and Kieser, M. Influence of a 7-day treatment with Ginkgo biloba special extract EGb 761 on bleeding time and coagulation: a randomized, placebo-controlled, double-blind study in healthy volunteers. Blood Coagul.Fibrinolysis. 2004;15(4):303-309. (15)Le Bars PL, Katz MM, Berman N, et al. A placebo-controlled, double-blind, randomized trial of an extract of ginkgo biloba for dementia. JAMA 1997;278:1327-32. (16)Le Bars PL, Kieser M, Itil KZ. A 26-week analysis of a double-blind, placebo-controlled trial of the Ginkgo biloba extract EGb761 in dementia. Dement Geriatr Cogn Disord. 2000;11:230-237. (17)Moher D, Pham B, Ausejo M, Saenz A, Hood S, Barber GG. Pharmacological management of intermittent claudication: a meta-analysis of randomised trials. Drugs. 2000;59(5):1057-1070. (18)Nathan, P. J., Harrison, B. J., and Bartholomeusz, C. Ginkgo and memory. JAMA. 2-5-2003;289(5):546-548. (19) dr.Petri Gizella:. Gyógynövények és készítmények a terápiában Galenus 2006. (20)Pittler MH, Ernst E. Ginkgo biloba extract for the treatment of intermittent claudication: a meta-analysis of randomized trials. Am J Med. 2000;108(4):276-281. (21)Schötz, Karl (2004). “Quantification of allergenic urushiols in extracts of Ginkgo biloba leaves, in simple one-step extracts and refined manufactured material(EGb 761)”. Phytochemical Analysis 15. (22)Smith (1996). “The neuroprotective properties of the Ginkgo biloba leaf: a review of the possible relationship to platelet-activating factor (PAF).”. Journal of ethnopharmacology 50 (3): 131–9. (23)dr. Tariska Péter: A XXI. század egyik nagy kihívása: a vascularis dementia Agyérbetegségek 2002;7(1):2-9. OPNI Memória Klinika, Budapest (24)Van Dongen, M., van Rossum, E., Kessels, A., Sielhorst, H., and Knipschild, P. Ginkgo for elderly people with dementia and age-associated memory impairment: a randomized clinical trial. J Clin Epidemiol. 2003;56(4):367-376. (25) Vellas, B., and Grandjean, H. Association of Alzheimer's disease onset with ginkgo biloba and other symptomatic cognitive treatments in a population of women aged 75 years and older from the EPIDOS study. J Gerontol A Biol.Sci.Med Sci. 2003;58(4):372-377. (26)Woelk, H; Arnoldt, KH; Kieser, M, Hoerr, R:Ginkgo biloba special extract EGb 761 in generalized anxiety disorder and adjustment disorder with anxious mood: A randomized, double-blind, placebo-controlled trial. Journal of Psychiatric Research 41 (2007) 472-480

## EFEKTET KRYESORE

### I. SISTEMI NERVOR

1. pengon humbjen e lëngjeve të membranës së qelizave dhe nervave
2. ndihmon shfrytëzimin e oksigjenit nga qelizat
3. përmirëson marrjen e oksigjenit dhe sheqerit nga indet (përparësi sidomos në tru!)
4. përmirëson tolerimin e gjendjes së mungesës së okigjenit, ul sasinë e dëmtimit
5. përmirëson efektivitetin e proceseve metabolike
6. stimulon proceset që prodhojnë energji
7. përmirëson funksionet e trurit – rritet shpejtësia e informacionit në qelizat e trurit
8. përmirëson rënien e lehtë dhe të mesme të kujtesës

Studime klinike kanë vërtetuar që është plotësues me efekt i trajtimit të sëmundjeve të mëposhtme:

a) rënia e inteligjencës
b) sëmundja Alzheimer
c) depresion, ankth, sëmundje paniku
d) stres

### II. ZEMRA DHE SISTEMI I QARKULLIMIT TË GJAKUT

1. përmirëson qarkullimin e gjakut në muskulin e zemrës (edhe në zmadhimin e zemrës!)
2. pengon dëmtimin nga mungesa e oksigjenit (parandalim infarkti dhe riabilitim)
3. përmirëson gjendjen në çrregullimin e ritmit të zemrës
4. ul tkurrjen e enëve të vogla të gjakut
5. stabilizon depërtueshmërinë e kapilarëve, duke ngadalësuar me këtë krijimin e ëdemës nga mungesa e oksigjenit
6. rrit distancën e ecjes në rastën e çalimit të herëpashershëm të shkaktuar nga ngushtimi i enëve të gjakut, përmirëson uljen e dëgjimit, tringëllimën në vedh, problemet e shikimit, marrjemendjen, problemet e potencës dhe të funksionit të veshkave të shkaktuara nga çrregullimet e qarkullimit të gjakut
7. përmirëson simptomat e plakjes dhe shton mbajtjen e ngarkesës
8. normalizon tensionin e gjakut
9. ka efekt të mirë në gjendjen pas trombozës
10. përshpejton shërimin e plagëve
11. përmirëson simptomat e hemorroideve
12. përmirëson funksionin e qelizave nervore të dëmtuara qarkullimi i gjakut

### III. METABOLIZMI

1. ul nivelin e kolesterinës
2. përmirëson marrjen e karbohidrateve
3. mbron nga pasojat e vonta të sëmundjes së sheqerit mbi enët e gjakut (dëmtimi i syve, gjymtyrëve, veshkave, nervave)

### IV. TË TJERA

1. parandalon tkurrjen e bronkeve në astmë dhe alergji
2. përmirëson gjendjen në sëmundjet inflamative
3. ndihmon tretjen



Pamjaftueshmëria e trurit të njerëzve të moshuar: Në krahasim me grupin kontroll tek të sëmurët që ndodhen në stadin fillestar u përmirësua në mënyrë të dukshme memoria, vëmendja dhe gjendja emicionale. U ul nervozizmi, problemet e identifikimit, u përmirësua gjendja e përgjithshme shpirtërore. Meqë qelizat e trurit nuk janë në gjendje të rigjenerohen, në rastet më serioze të demencës dhe sëmundjes Alzheimer përmirësimi i simptomave ishte më i vogël, por u parandalua rënia e shpejtë.
Në rastin e dëmtimit të enëve të gjakut që shkakton ndryshime akute të trurit (stroke) trajtimi me dozë të lartë Egb 761 i filluar në stadin fillestar e uli numrin e rasteve që përfundojnë me vdekje. Në shumicën e rasteve u përmirësuan simptomat e pamjaftueshmërisë së trurit, dhe kishte më pak pasoja të përhershme.
Tkurrja e enëve të gjakut (spazma) që shfaqet në formë ataku në mënyrë simetrike në gishtrinjtë e të dy duarve apo këmbëve nga i ftohti apo stresi – sëmundja Raynaud - ndodhi më rrallë.
Mungesa e oksigjenit (hypoxia) në muskuj e krijuar si rrjedhim i pengesës së qarkullimit periferik të gjakut shkakton dhembje dhe mpirje. Nëse mungesa e oksigjenit ekziston për një kohë të gjatë, kryesisht tek të sëmurët me ngushtim të enëve të gjakut, shfaqet herë pas here çalimi i dhimbshëm, claudicatio intermitens. Pas trajtimit me EGb 761 u ul numri çalimeve dhe dhembja, u zbraz ëdema.
U vërtetua që kjo lëndë ka efekt të mirë edhe në enët kurorë të zemrës (coronaria), përmirëson funksionin e zemrës, si efekt i tij ulet krijimi i trombozës dhe në këtë mënyrë edhe i infarktit të zemrës. Si rrjedhim i aftësisë penguese të PAF ka efekt antialergjik, kështu që të sëmurëve asmatik Egb 761 u ul simptomat dhe shpeshtësinë e atakeve.
Trajtimi me EGb 761 pati efekt edhe në rastin e marrjemendjes, vjelljes, tringëllimës në vesh të shkaktuar nga çrregullimi i qarkullimit të gjakut të qendrës së trurit, si edhe në atë të dëmtimit të organit ekuilibrues.
Ka efekt të mirë edhe në rastin e dëmtimit të dëgjimit (tek të sëmurët e trajtuar me të rezultati ishte me 2/3 më i mirë se sa tek ata të trajtuar me placebo).
Rezultatet e trajtimit të syve: duke përmirësuar qarkullimin e gjakut të enëve të fundit të syrit lënda pati efekt të mirë në rastin e degjenerimit të pigmentit të retinës. Me marrjen e 160 mg në ditë u përmirësua shikimi, ose u ul intensiteti i prishjes së tij.
Në rastin e dëmtimeve nga djegiet ekstrakti Ginkgo pengon rrjedhjen e gjakut ndërmjet indeve, duke ndihmuar me këtë shërimin.
